



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KESHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Doretuar Prijmjen / Predato Received / Delivered	01.12.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org. / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Pr. Prot Prot No	Shërbimi Prilog Appendix	Sasia Koliciteta Quantity
SKINSHEK	7193/2023		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1249/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbaitëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1249/2023, të datës 05.10.2023, të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike „shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.1249/2023, e datës 05.10.2023, e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi** Vendimi KA.nr.34/2023, i datës 02.10.2023, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile (më tej referuar vetëm *ankuesja*), me datë 03.10.2023, përmes Postës së Kosovës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar me datë 05.10.2023 në Këshill, kundër Vendimit me numër KA.nr.34/2023, të datës 02.10.2023, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për shkak të ekzistimit të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale si dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*këtu e tuje Këshilli*, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 11.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Sekretariatit i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (*tutje SKGJK*), ndërsa, ky i fundit, me datë 16.11.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 7011/2023, të datës 16.11.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1249/2023 të datës 05.10.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6397/2023 të datës 05.10.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KA.nr.34/2023 të datës 02.10.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; E-mailin zyrtar të datës 02.10.2023 ndërmjet ankueses dhe E.V lidhur me dërgimin e vendimit të KZKA-së; Akt emërimit e ankueses me Nr.03/953 të datës 30.06.2023; Rregulloren me Nr.01/1080 të datës 31.12.2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Themelore dhe Degët e Tyre; Organogramin e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe degët; Konkursin me Nr.02/2022 të datës 13.06.2022 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimin me numër A.nr.917/2023 të datës 17.08.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Katalogun e Pozitave dhe Përshkrimit të Vendeve të Punës për të Punësuarit e Gjyqësorit me Nr.01/679 të datës 17.05.2022; Përshkrimet e detyrave të punës për pozitën Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve; Përgjigjen në ankesë të datës 16.11.2023 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Ankesën e ankueses me Nr.01/1452 të datës 26.09.2023 e parashtruar tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimin me Nr.01/57 të datës 23.01.2023 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për të Punësuarit në Gjyqësor si dhe Vendimin me numër protokollit 7011/2023 të datës 16.11.2023 nga Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës së ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e pabazuar, sepse:**

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja është e punësuar në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe se e njëjta sipas Aktit të emërimit me numër të referencës DS 424 të datës 30.06.2023, ushtron pozitën e punës Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve në Gjykatën Themelore në Gjakovë.

Lidhur me objektin e shqyrtimit të kësaj lënde, Kolegji nga provat e lëndës ka gjetur se me datë 23.01.2023, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, lidhur me zbatimin e shtojcës nr.2-Sistemi Gjyqësor, të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ka nxjerrë Vendimin me numër KGJK.nr.01/2023, për Klasifikimin e Vendeve të Punës për të Punësuarit në Gjyqësor, vendim ky i zbatueshëm nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Rrjedhimisht, sipas këtij vendimi pozita e ankueses Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve, është klasifikuar në grupin e pozitave profesionale Grupi J, klasa J15, Koeficienti 5.85, kështu që bazuar edhe në këtë vendim, organi i punësimit pas përfundimit të konkursit 02/2020 të datës 13.06.2022 dhe përzgjedhjes së ankueses për pozitën e shpallur Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve, në Gjykatën Themelore në Gjakovë, ka lëshuar për ankuesen Akt emërimit me numër të referencës DS 424 të datës 30.06.2023, Grupi J, klasa J15, Koeficienti 5.85, i nënshkruar nga ankuesja me datë 03.07.2023.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesja me datë 26.09.2023 ka parashtruar ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për harmonizim të koeficientit nga Grupi J, Klasa J15, koeficient 5.85, në Grupin J, Klasa J14, me koeficient të pagës 8, ndërsa, me datën 02.10.2023 Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave përmes Vendimit me numër KA.nr.34/2023 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se me rastin e aplikimit në konkursin e brendshëm me Nr.02/2022 për pozitën Mbikëqyrës i Sektorit Për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve sipas kodit DR/880 me nivel të koeficientit 8 dhe se pozita në fjalë ishte paraparë si pozitë e nivelit drejtues apo menaxherial ndërsa thekson se lidhur me këtë pozitë për koeficientin e pagës prej 5.85 është njoftuar tek me rastin e nënshkrimit të Akt emërimit. Tutje shton se kategorizimi vendit të punës që ishte bërë në aktin e emërimit dhe në bazë të të cilit është përcaktuar koeficienti i pagës ka qenë degradim ngase e njëjta kishte aplikuar në bazë të konkursit me Nr.02/2022 për pozitën e njëjtë me koeficient të pagës 8 sipas Grupit J, Klasa J14. Po ashtu thekson faktin se me anë të Vendimit me Nr.01/57 të datës 23.01.2023 për

Klasifikimin e Vendeve të Punës për të Punësuarit në Gjyqësor, asnjëherë nuk është shfuqizuar Rregullorja 07/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe se e njëjta është ende në fuqi dhe ka karakter obligator për sa i përket kategorizimit e që pozita në fjalë edhe sipas Katalogut me Nr.01/679 të datës 17.05.2022 është e paraparë me koeficient të pagës 8. Kërkon që ti aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet Vendimi me numër KA.nr.34/2023 i datës 02.10.2023 i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ashtu që të korrigoj Akt emërimit me Nr.03/1269 të datës 31.08.2023 nga koeficienti 5.85 në atë 8 si dhe të obligohet Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës t'ia kompensoj në mënyrë retroaktive diferencën e pagës së munguar sipas koeficientit 8 apo 7.5 për pozitën Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe atë nga muaji shtator 2023 e deri për atë kohë sa një diferencë e tillë mbetet e papaguar për muajt vijues përkatës.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës, Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin është përcaktuar se: *1. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj.* Ndërlidhur me këtë me nenin 127 paragrafin 1 të të njëjti ligj parashihet se: *"1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ..."*. Andaj, nisur nga ky përcaktim ligjor dhe bazuar në provat materiale të kësaj çështje administrative, Kolegji konstatoi se ankuesja me datë 03.07.2023 ka nënshkruar pa vërejtje Aktin e emërimit me numër të Referencës: DS-424/2023, Grupi J, klasa J15, Koeficienti 5.85 të pagës, ndërsa e njëjta me datë 26.09.2023, parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SKGJK për klasifikim të pozitës së saj në Grupin J, Klasa J14, me koeficient të pagës 8, kështu që mbi këto fakte rrjedhë se ankesa e ankueses e parashtruar më datë 26.09.2023 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së, është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pra nga data e nënshkrimit të aktit të emërimit 03.07.2023 e deri në datën e parashtrimit të ankesës në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së kanë kaluar mbi 30 ditë, dhe si pasojë pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Bazuar në arsyetimin si më sipër, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1249/2023

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhukaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të SKGJK-së;
- Arkivit të KPMSHCK-së